

**URDHËR**  
**Nr. 373, datë 30.8.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021, “PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gjerat “d”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614, datë 30.8.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1 e urdhrin riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 23:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 1.9.2021 deri më datë 14.9.2021”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 1.9.2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE**  
**MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**